



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:185074  
Datë: 21.12.2022  
Numri i dokumentit: 03783453

PAKR.nr.70/2022

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti i Krimeve të Rënda, në Kolegjin Penal të përbërë nga gjyqtarët, Tonka Berishaj kryetare, Burim Ademi dhe Bashkim Hyseni anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Alba Makolli, në çështjen penale kundër të akuzuarit Z.E. nga fshati ..., Komuna e Klinës, për shkak të veprës penale Konflikt interesi nga neni 424 par.1 të KPRK-së, duke vendosur në lidhje me ankesën e Prokurorisë Themelore në Pejë dhe ankesën e mbrojtësit të akuzuarit Z.E. avokati Kujtim Kërveshi, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.95/21 të dt.17.12.2021, në seancën e kolegjit me datë 12.04.2022 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Aprovohet ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit Z.E. av. Kujtim Kërveshi, dhe Ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr. 95/2021 i datës.17.12.2021, dhe në:

Mbështetje te nenit 364 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 te KPP - ës:

**LIROHET NGA AKUZA**

Sepse:

Me datë.20.02.2018 ne Klinë si person zyrtar në cilësinë e kryetarit të Komunës së Klinës, edhe pse e ka ditur se vajza e tij ka për të aplikuar ne pozitën mjekje të praksës së përgjithshme në QKMF në Klinë, ka marrë pjesë personalisht në çështjen zyrtare – administrative duke marrë vendimin nr.112-891-2018 të datës 20.02.2018 me të cilin ka formuar komisionin për zhvillimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës bazuar në konkursin e publikuar me datë.02.02.2018 për pozitën Mjek i praksës se përgjithshme ( një ekzekutuese), ne atë mënyrë qe komisioni në fjalë e ka përzgjedhur vajzën e të akuzuarit si me të suksesshme duke punësuar të njëjtën si mjekje e praksës së përgjithshme në Qendrën e Mjekësisë Familjare “ Nënë Tereza” në Klinë.

Me këtë kishte për të kryer vepër penale konflikti i interesit nga neni 242 paragrafi 1 i KPRK-ës.

Shpenzimet e procedurës penale mbesin në barrën e buxhetit të gjykatës.

Ankesa e prokurorisë është jo lëndore.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, ka marrë aktgjykimin PKR.nr.95/2021 të dt.17.12.2021, me të cilin të akuzuarin Z.E. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Konflikt interesi nga neni 424 par.1 të KPRK-së, dhe është gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 4000 (katërmijë) euro, të cilin dënim është i obliguar që ta paguajë në afat prej 6 (gjashtë) muaj, nga data e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse, i akuzuari dënimin me gjobë nuk e paguan në afatin e caktuar, atëherë dënimi me gjobë të zëvendësohet me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim për çdo 20 (njëzet) euro të gjobës.

Është obliguar i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 150 (njëqind e pesëdhjetë) euro, si dhe shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto do të ekzekutohen në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Kundër këtij aktgjykimi kanë parashtruar ankesë:

Prokuroria Themelore në Pejë për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal dhe mos shqiptimit të dënimit plotësues, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, ashtu që të ndryshohet aktgjykimi dhe ndaj të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i lartë si dhe dënimin plotësues konform nenit 65 par.2 të KPRK-së.

Mbrojtësi i të akuzuarit Z.E. avokati Kujtim Kërveshi për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që të aprovohet ankesa, ndërsa aktgjykimi të anulohet dhe i akuzuari të lirohet, apo lënda të kthehet në rivendosje.

Përgjigje në ankesën e Prokurorisë Themelore në Pejë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit Z.E. avokati Kujtim Kërveshi, me propozim që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Prokuroria e Apelit, ka paraqitur parashtrësën me shkrim PPA/I.nr.82/22 të datës 08.02.2022, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë ashtu që aktgjykimi të ndryshohet sa i përket vendimit mbi dënim, ndërsa të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit.

Gjykata e Apelit pasi që ka studiuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore dhe mbrojtësit të akuzuarit, propozimin e Prokurorisë së Apelit, dhe duke analizuar shkresat e lëndës në këtë çështje penale në vështrim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, gjeti se:

Ankesat e mbrojtësit të të akuzuarit është e bazuar ndërsa ankesa e prokurorisë është jo lëndore.

*Pretendimet ankimore.*

Në ankesën e Prokurorisë Themelore në Pejë, theksohet se nuk është caktuar drejtë dënimi ndaj të akuzuarit, duke u mbivlerësuar rrethanat lehtësuese. Fillimisht, sa i përket rrethanave lehtësuese, gjykata ka bërë vlerësim jo adekuat ku rrethanat e vlerësuara janë jo adekuate lidhur me përcaktimin e lartësisë së dënimit. Nuk është marrë për bazë rrethana rënduese keqpërdorimi

i pushtetit nga personi i dënuar, për faktin se ka qenë në pozitën e Kryetarit të Komunës. Sipas ankesës, janë dashur të merren parasysh rrethanat rënduese, si shkalla e lartë e dashjes se vepra penale paraqet sulm ndaj vlerave shoqërore dhe tregon angazhim dhe vazhdimësi më të madhe. Pastaj, shkalla e dëmit të shkaktuar, se vepra paraqet imazh të keq, dhe cenimi i detyrës zyrtare nga ana e personave zyrtarë përmes shfrytëzimit të kundërligjshëm të pozitës dhe autorizimeve zyrtare. Lidhur me dënimin plotësues – ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose shërbim publik, sipas ankesës nuk është shqiptuar nga gjykata edhe pse herën e parë e kishte shqiptuar, edhe pse nuk ka ndryshuar asgjë nga gjendja faktike. Kështu, theksohet se dënimi i shqiptuar nuk do të arrijë qëllimin e dënimit dhe do të ndikojë negativisht në opinion dhe po e dëmton besimin kolektiv, andaj me ashpërsimin e dënimeve do të kthehet besimi në institucione. Andaj, në këto rrethana është propozuar si më lartë.

Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit Z.E. avokati Kujtim Kërveshi, pretendohet se gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar gjendjen faktike, është i pa kontestueshëm fakti se i akuzuari ka nënshkruar vendimin me nr.112-891-2018 të dt.20.02.2018, me të cilën është formuar komisioni për zhvillimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës bazuar në konkursin e publikuar me datë 02.02.2018, për pozitën mjek i praksës së përgjithshme. Lidhur me dashjen, mbrojtja konsideron se është e nevojshme të sqarohen procedurat standarde nga Njësia e Burimeve Njerëzore – Personelit. Në rigjykim, është dëgjuar dëshmitari XH.D., i cili ka dhënë sqarime në lidhje me procedurat në departamentin e burimeve njerëzore ku i është referuar në veçanti dhe është sqaruar rrethana, se kryetarit të komunës i dërgohet vetëm propozimi vendimi për themelimin e komisionit për zhvillimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës për nënshkrim dhe në asnjë rast nuk i dërgohet lista e aplikuesve, e as aplikacionet dhe në mënyrë bindëse kjo rrethana është sqaruar e propozuar nga Gjykata e Apelit. Me këtë rrethanë, provohet në mënyrë bindëse, se nuk ka ekzistuar dijenia e as dashja. Lidhur me aspektin kohor, se kur është realizuar biseda në mes të Kryetarit të Komunës të akuzuarit Z. dhe nën Kryetarit B.H., është vërtetuar se është bërë një bisedë në mes të kryetarit dhe nën kryetarit në lidhje me fëmijët e tyre, kjo bisedë e zhvilluar shumë kohë para shpalljes së konkursit dhe asnjëherë nuk është bërë bisedë për rastin konkret. Në lidhje, me kërkesën e Gjykatës së Apelit, se a aludohet për vajzën e të akuzuarit, nga deklarata e dëshmitarit B., vërtetohet se në asnjë moment nuk është aluduar në asnjërin nga vajzat e kryetarit, por biseda është zhvilluar në kuptim të përgjithshëm. Në bazë, të dëshmitarit B.H.t dhe mbrojtjes të akuzuarit, në asnjë moment nuk është bërë bisedë për ndonjë konkurs të veçantë, pasi biseda është zhvilluar shumë kohë para shpalljes së konkursit. Mbrojtja, i është referuar faqes 13 të aktgjykimit, të cilat i gjen

si konstatime të pabazuara, dhe përjashtimi i dy provave është në kundërshtim me dispozitat e kodit të procedurës penale respektivisht përgjigja me shkrim e mendimit në lidhje me nenin 424 të prokurorit SH.F.. Ky mendim, e nxjerr ligjërisht nga përgjegjësia penale të akuzuarin dhe shkëmbimi i e-mailave jep konstatime profesionale të zyrës së Kryeprokurorit dhe prokurorit koordinator për korrupsion dhe nga ky mendim prokuroria Themelore në Pejë ka ndërmarrë veprime dhe ka siguruar mendimin edhe nga Agjencia kundër korrupsionit, e cila ka kthyer zyrtarisht përgjigje. Argumenti i prokurorisë për ta kundërshtuar këtë provë, është në kundërshtim me KPP. Sipas ankesës, konstatimi i trupit gjykues dhe përjashtimi i provave me arsyetimin se nuk janë propozuar, është i kundërligjshëm dhe e dëmton rëndë të akuzuarin për shkak së janë prova shfajësuese. Edhe pse trupi gjykues ka aprovuar propozimin e mbrojtjes që të lexohet vendimi i dt.10.05.2017 dhe vendimi i Kryetarit të komunës – zyra e personelit të dt.10.05.2017. Mbrojtja e konsideron tejet të rëndësishëm, mendimin e prokurorit të shtetit SH.F., i cili kishte këshilluar prokurorin që të kërkonte opinionin ligjor nëse nënshkrimi bart përgjegjësi për këtë person (pra për nënkryetarin e komunës), apo për personin në emër të cilit nënshkruhet pra për kryetarin e komunës. Pra, sipas ankesës, përgjegjësia e nënshkrimit mbi nënkryetarin, e jo kryetarin tani të akuzuarin. Më tutje, mbrojtja nuk e konsideron si të drejtë konstatimin e gjykatës, në lidhje me deklaratën e dëshmitarit B.H., edhe pse nga deklarata e tij nuk mund të vërtetohet fakti se i akuzuari me rastin e nënshkrimit të vendimit ishte në dijeni se vajza e tij do të aplikonte në pozitën e mjekes. Për mbrojtjen, e të akuzuarit është e paqartë dhe absurde si dhe duke u bazuar në rrethana faktike u vërtetuar, se çfarë u bisedua në mes të akuzuarit Z. dhe dëshmitarit B., e cila sipas mbrojtjes deri tek ky konstatim ka ardhur vetëm në bazë të supozimit. Mbrojtja, nuk e di se nga ka ardhur konstatimi i trupit gjykues, i akuzuari a ka vazhduar konfliktin e interesit me rastin, kur i bartë kompetencat tek nënkryetari, apo çfarë në të vërtetë ka vërtetuar trupi gjykues dhe rrethana e bartjes së kompetencave tek nënkryetari, që e vërteton trupi gjykues, është veprim kur i akuzuari shmang konfliktin e interesit, pasi që e kishte marrë vesh se vajza e tij, kishte aplikuar në pozitën e mjekes. Kështu, theksohet se gjykata nuk ka arsyetuar se përse nuk ia falë besimin deklaratave të dëshmitarëve XH.RR., G.B. dhe B.H., çka bie në kundërshtim me nenin 7 par.1 dhe 2 të KPP-së. Këto deklarata, kanë qenë në favor të akuzuarit, sepse të tre kanë qenë pjesë e komisionit për rekrutim dhe njëzëri kanë deklaruar se komisioni ka vendosur në bazë të meritokracisë dhe nuk kanë mundur ta dinin se kush ka aplikuar dhe vërtetohen pohimet e të akuzuarit, se asnjëherë nuk ka bërë presion tek ky komision. Ndërsa, provat në faqen 11 dhe 12 të aktgjykimit janë jo relevante. Të akuzuarin, asgjë nuk e ka penguar që ti bartë kompetencat tek nën kryetari i komunës dhe të njëjtin vendim do ta nënshkruante nën kryetari i Komunës, ashtu si i akuzuari ka bartur kompetencat posa e ka kuptuar që vajza e tij ka

aplikuar, pasi e ka nënshkruar vendimin mbi themelimin e komisionit. Në rastin konkret, mos lajmërimi i Agjencisë Kundër Korrupsionit, ka të bëjë me shkelje disiplinore dhe i akuzuari ka pranuar dhe ka qenë shumë i sqartë se askush nuk e ka informuar se duhej njoftuar AKK-ja. Kështu, theksohet se i akuzuari ka vepruar konform nenit 59 pika 2 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, për faktin se në momentin e rënies në dijeni për vajzën e tij, është vet përjashtuar nga vendimmarrja. Në rastin konkret, është shkelur edhe ligji penal sepse ka munguar dashja e të akuzuarit dhe vepra nuk përbën veprë penale. I akuzuari nuk ka marrë pjesë personalisht në marrjen e vendimit për vajzën e tij sepse në momentin e rënies në dijeni, është vet përjashtuar dhe procedurën e ka udhëhequr nën kryetari. Nga sqarimi i Ministrisë për Pushtet Lokal, është sqaruar se nënshkrimi për, bie mbi përgjegjësinë e nënkryetarit. Si rrjedhojë, dispozitivi i aktgjykimit dhe arsyetimi është kundërtë në mes vete nga neni 384 par.1 nën par.1.12 të KPP-së. Me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari e ka ditur se vajza e tij ka aplikuar, edhe pse gjykata e shkallës së parë e shpall fajtor se kinse ka qenë në dijeni. Gjykata ka qenë e njëanshme dhe nuk i ka përfillur deklaratimet e dëshmitarëve dhe provave materiale, dhe është vërtetuar se i akuzuari nuk ka qenë në dijeni se vajza e tij ka aplikuar. Më tutje, theksohet se zyra e personelit e formon komisionin, ndërsa kryetari ka autorizim për të nënshkruar të gjitha dokumentet e organeve komunale, të njëjtin dokument e ka nënshkruar dhe e ka aprovuar formimin e komisionit. I akuzuari në asnjë mënyrë nuk e ka formuar komisionin, që i bie se kryetari i komunës nuk i zgjedh anëtarët e komisionit, pra ka dallim mes formimit dhe aprovimit të komisionit. Në këto rrethana është propozuar si më lartë.

Në përgjigjen në ankesë të Prokurorisë Themelore në Pejë, të paraqitur nga mbrojtësi i të akuzuarit Z.E. avokati Kujtim Kërveshi, theksohet se rrethana e vlerësuar si faktin se nuk ka qenë i akuzuari i pa dënuar më parë, sipas prokurorisë është vlerësim jo adekuat. Ndërsa, sipas mbrojtjes me kodin penal parashihet një rrethanë e tillë me nenin 70 par.2 nën par.2.12 dhe par.3 nën par.3.3 të këtij neni. Pra, sipas mbrojtjes është vlerësuar drejtë rrethana se i akuzuari nuk ka qenë i dënuar më parë, sepse një rrethanë e tillë vlerësohet edhe sipas praktikës gjyqësore. Mbrojtja, konteston konstatimin e prokurores në lidhje me rrethanat tejet rënduese, sepse ligjvënësi nuk bën një dallim të tillë. Ndërsa, rrethanat veçanërisht rënduese, parashihen vetëm tek veprat penale që parashohin burgim të përjetshëm. Lidhur me pretendimin ankimor, se i akuzuari ka keqpërdor pushtetin, sipas udhëzuesit ndalohet llogaritja e dyfishtë e rrethanave dhe gjykata nuk merr parasysh rrethanat që janë element i veprës penale. Se i akuzuari ka vepruar në pozitën e kryetarit të komunës, sipas mbrojtjes me KPRK-në, nuk bëhet dallimi i personave zyrtar. Lidhur me pretendimin ankimor të shkallës së dashjes, prokuroria nuk ka paraqitur fare

veprimet e të akuzuarit, ndërsa mbrojtja në ankesë ka paraqitur pretendime të mjaftueshme se tek i akuzuari ka munguar dashja. Në lidhje me shkallën e dëmit, sipas mbrojtjes i akuzuari është tërhequr nga vendim marrja ku ka qenë vajza e tij, që për mbrojtjen është veprim që duhet përcjellë edhe të parët e komunave tjera. Në lidhje me dënimin plotësues, mbrojtja thekson se nuk është detyrim i gjykatës, por mundësi shqiptimi. Lidhur me pretendimin se përse në rigjykim nuk është shqiptuar dënimi, mbrojtja bën një pyetje tjetër, pse gjykata vërtetohet se i akuzuari e kishte ditur se vajza e tij ka aplikuar në pozitën e mjekes, ndërsa në rigjykim gjykata konstatohet se i akuzuari kishte për ta ditur se vajza e tij kishte për të aplikuar. Në këto rrethana, mbrojtja ka propozuar si më lartë.

### **Gjetjet e Gjykatës së Apelit**

Gjykata e Apelit duke vlerësuar aktgjykimin e ankimuar e duke marr për bazë provat që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor, ka vlerësuar ato dhe ka konstatuar se me provat që janë administruar në gjykatën e shkallës së parë nuk provohet se i akuzuari ka kryer veprë penale për të cilën është akuzuar, andaj kjo gjykatë në mbështetje të nenit, 403 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, ka konstatuar se gabimisht është vërtetuar gjendja faktike me konkretisht rezulton se gjykata e shkallës së parë faktet relevante që përbëjnë elementet e veprës penale, për të cilën ngarkohej i akuzuari i ka vërtetuar gabimisht, bazuar në provat që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor, andaj kolegji duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore edhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se në këtë çështje penale faktet relevante nga të cilat varet zbatimi i dispozitës penale materiale për veprën penale që ngarkohej i akuzuari ishin, se: “I akuzuari ngarkohej se në cilësinë zyrtare – Kryetar i Komunës duke e ditur se vajza e tij ka aplikuar për një pozite në QKMF për mjekë të praksës së përgjithshme, ai ka marrë pjesë në një çështje zyrtare – administrative, duke e themeluar komisionin për rekrutim sipas vendimit nr. 112-891-218 me datë 20.02.2018, për konkursin që ishte shpallur me datë 20.02.2018.

Kolegji ka vlerësuar pretendimet ankimore të mbrojtjes që ndërlidheshin me faktet relevante në këtë çështje penale e këto pretendime i ka vlerësuar në raport me faktet e çështjes duke i vlerësuar edhe provat që mbështesnin këto fakte relevante në këtë çështje penale.

Me konkretisht, dëshmitari B.H. kishte deklaruar, në dëshminë e tij të dhënë para gjykatës me dt.25.10.2021 ka deklaruar se mbetem pranë deklaratës që kam dhënë para gjykatës në shqyrtimin e mëparshëm, po ashtu edhe pranë deklaratës që kam dhënë në prokurori. Me kryetarin (kryetarin i referohet të akuzuarit) kanë folur për familjarët e tij e po ashtu edhe për familjarët e të akuzuarit dhe atë kanë bërë disa biseda të lira. Ka kaluar një kohë gjatë dhe mund të gaboj, i kujtohet që ka nënshkruar në mungesë të kryetarit shumë vendime, por nuk e di për cilin rast, por kur behet fjalë për vajzën e kryetari e ka nënshkruar në mungesë të kryetarit, dhe e di që e ka nënshkruar një vendim që është kryer konkursi pasi që bëhet fjalë për vajzën e kryetarit. Lidhur me mungesën e mjekëve në Komunë së Klinës njëjti ka deklaruar se sa të interesuar ka pas, por se a ka pas mjaftueshëm aplikant nuk e di.

Ky nuk e ka ditë se kryetari këtu akuzuari e ka ditur se ka aplikuar vajza e tij për mjekte e praksës së përgjithshme pasi ballafaqohet me deklaratën e dhënë në prokurori 09.02.2019 ku kishte theksuar ju keni deklaruar se është dashur me ditë por saktë nuk e di, i njëjti është përgjigjur "po". Pastaj thekson se me kryetarin kemi biseduar edhe për djem edhe për vajza dhe për krejt. Dëshmitari pastaj ka pohuar sërish se ka biseduar me kryetarin ku i njëjti kishte thënë kohë më parë "se nuk e di se qysh kam me mund me marrë një vajzë se ajo është e mirë", dhe se këtë bisedë e që kanë zhvilluar ka mundur me qenë para shpalljes se konkursit dhe shumë kohë më përpara. Kryetari i ka katër fëmijë dhe që të gjithë janë të diplomuar. Dy vajza i ka mjekte, një djalë e ka inxhinier apo arkitekt, dhe tjetrin e ka ekonomist apo jurist. Që të dy vajzat i ka pas të punësuar aty në Klinë në QKMF, por në periudha të ndryshme. Që të dyja janë shkuar jashtë shtetit dhe na kanë lanë keq. Me kryetarin për vajzën është diskutuar shumë më përpara para se me u shpallur konkursi, nuk ka qenë as në rënd me u shpallur konkursi. Pas shpalljes së konkursit nuk kanë biseduar dhe ky e kishte nënshkruar vendimin në mungesë të kryetarit. Kur e ka shkruar edhe pse kanë qenë emrat nuk e ka ditur që është vajza e kryetarit. Kontratat i ka nënshkruar në mungesë të kryetarit. Nuk i kujtohet që kryetari ta ketë njoftuar për konflikt interesi, veç i kujtohet se kryetari nuk ka qenë aty. Këtij personalisht zyra ligjore ika dërguar kontrata për nënshkrim, në mungesë të kryetarit. Dëshmitari ka mbetur pranë deklaramit të tij se kryetari nuk e kishte njoftuar dikë në ndonjë mbledhje se vajza e ti ka aplikuar për mjekte, dhe meqenëse paraqet konflikt interesi si kryetar tërhiqem nga procedura administrative dhe vendim marrja. Në bisedë e sipër me kryetarin kanë biseduar që ka mungesë të madhe të mjekëve në QKMF në Klinë dhe se nuk ka pasur aplikant të mjaftueshme dhe asnjëherë nuk ka shpreh ndonjë dyshim të paraqitet konflikt interesi, dhe është shumë i bindur se nuk e ka bërë me ndonjë qëllim të keq por më shumë ka ndodhur nga neglizhenca. Kur i ka nënshkruar kontratat i ka thënë shefit të protokollit i ka thënë tregoi kryetarit se i ka nënshkruar këto, dhe besoi se ai i ka thënë.



Personalisht kryetari i ka treguar të gjitha vendimet që i ka nënshkruar, por normal kjo është detyrë e shefit të protokollit, dhe shefi i protokollit është afër zyrës së kryetarit. Çdo herë në mungesë të kryetarit nënshkruan vendime dhe varësisht prej situatave dhe kur kryetari gjendet në udhëtime zyrtare. Kryetari ka dy vajza mjekë, dhe konkretisht kur kanë biseduar për punësimin e vajzës së tij, mohon të kenë biseduar me emër. Lidhur me deklarinimin se nga shefi i protokollit njoftohet kryetari për nënshkrimet e tij i njëjti mohon të ketë qenë prezent.

Dëshmitari B.H. në shqyrtim gjyqësor të dhënë para gjykatës me dt.10.09.2020 kishte deklaruar se e njehë Z.E. meqenëse janë në koalicion ai është kryetar e ky nënkryetar i Komunës së Klinës. Në pozitën e nënkryetarit është që nga 26.12.2017. Në mungesë të kryetarit kur është jashtë shtetit nënkryetari i zbaton kompetencat e kryetarit, ka nënshkruar vendime në emër të tij në mungesë të tij. Nuk ka pasur autorizim me shkrim për të nënshkruar vendimet por ka vepruar në bazë të ligjit, por nuk ka pasur rast të nënshkruaj shumë vendime apo ndonjë vendim të rëndësishëm, por sikur të kishte pas ndonjë rast me siguri që iu kish dashtë autorizimi nga kryetari. Në rastin konkret kërkesat kanë ardhur prej QKMF, aplikantët kanë aplikuar pasi që është shpallur konkursi, komisioni është formua pasi që kanë aplikuar aplikantët me kohë të caktuar. nuk e dinë saktë datën. Formohen dy komisione njëri për rekrutim dhe tjetri për zhvillim e procedurave si komision që formohet më përpara me qëllim të përgatitjes së konkursit dhe zakonisht para se mu shpall konkursi. Vendimet për rekrutim dhe zhvillimin e procedurave të dyja janë të nënshkruara nga kryetari, Kryetari nuk ka biseduar me më të se ka aplikuar vajza e tij në këtë konkurs, mirëpo i kujtohet se një herë më parë kanë pas një bisedë se ka vajzën shumë të mirë dhe nuk e di si ka me mund me marrë. I kujtohet se në atë kohë Komuna e Klinës, e edhe sot e kësaj dite ka mungesë të mjekëve dhe mezi kanë pritë me ardhë dikush aty, dhe s'ka ardhë në shprehje vajza e kujt është, a e kryetarit apo e kujtdo qoftë. Madje, për fat të keq personi në fjalë e ka ndërprerë marrëdhënien e punës dhe i ka lënë keq. Kontratën e punës me numër 112/2191/18 e datës 26.03.2019 për kohë të pa caktuar në emër të M.E. e ka nënshkruar nënkryetari, nuk ka pas autorizim dhe se kryetari nuk ka qenë aty kur e ka nënshkruar këtë kontratë, mirëpo të njëjtin e ka njoftuar si zakonisht kur është kthyer. Dëshmitari i lartcekur pasi që është ballafaquar me deklaratën e dhënë në prokurori PP.nr.43/19 e datës 02.09.2019 faqe 3 paragrafi 5 në pyetje e mbrojtës i njëjti përgjigjet se nënshkrimi është i tij dhe se kur e ka nënshkruar kontratën për bijën e kryetarit nuk e ka njoftuar kryetarin si dhe ka nënshkruar edhe kur ka qenë emri i kryetarit. Në mungesë të kryetarit i ka ushtruar kompetencat e tij ligjore. Kur ka nënshkruar, kryetarin e ka njoftuar pasi që është kthyer. Nuk janë trajnuar nga Agjensioni kundër Korrupsion për rastet e konfliktit të interesit por kanë pasur komunikime me letra

drejtpërdrejtë. Kontratat i ka përgatit personeli. Dëshmitari B.H. në mënyrë të njëjtë ka deklaruar edhe me rastin e dhënies së deklaratës në prokurori me dt.02.09.2019.

Dëshmitari XH.D. në dëshminë e tij të dhënë para gjykatës me dt. 01.10.2021 ka deklaruar se Z.E. a e njeh si kryetar te Komunës dhe nuk është në raporte familjare me të. E kanë planin e personelit, ashtu që kur kanë pozita të lira administrata QKMF dhe arsim, në rastin konkrete Drejtori i Drejtorisë Komunale të Shëndetësisë dhe Mirëqenie sociale ka bërë kërkesë që të fillohet procedura e konkursit, ajo miratohet dhe bëhet shpallja publike, pas përfundimit të konkursit formohet paneli intervistues, nga zyrtari kryesore administrativ që është Kryetari i Komunës, pastaj panelit intervistues i dorëzohet lista dhe dosja komplete e aplikantëve, paneli intervistues i merr listat e aplikanteve krijon listën e ngushtë, pastaj caktohet data testi me shkrim. Pas atij testi del njoftimi kandidatet sa ka marrë pikë. E bëjnë publike dhe vendoset në tabelën e shpalljes. Pastaj caktohet intervista me gojë për kandidatet të cilët e fitojnë mbi 50% nga se ligji e përcaktojnë. Pas intervistës me gojë Kryetari i panelit intervistues e bënë një raport në mënyrë kronologjike për pikët me shkrim, pikët më goje, ato mblidhen dhe del kandidati i suksesshëm me renditje. Pastaj shkruhet vendimet për pranimin e kandidatit dhe jepet e drejta e ankesës, në qoftes se në afatin ligjorë nuk ka ankesë nga kundër kandidati atëherë lëshohet akt emërimi dhe atë e nënshkruar Kryetari i Komunës. Në qoftë se ka procedura ankesë atëherë nuk i lëshohet kontrata deri sa të përfundon procesi i ankesës. Në rastin konkretë ka qenë i njoftuar se nuk ka ankesë ligjore të kandidatëve. Nuk ka pasur ankesa sepse kur ka ankesa me njoftojnë. Pasi që mbyllet konkursi e tërë përgjegjësia bije mbi panelin intervistues dhe ky nuk merret më me intervistues deri me rastin nëse ka ankesa. Kryetari i Komunës e nënshkruan akt emërimin, mirëpo ky e përgatitë dhe kjo kompetencë është me Ligj. QKMF-ja kanë zyrtarin e vetë të personelit, mirëpo ky është udhëheqës i Njësisë së personelit. Këtë çështje e rregullon Ligji i shërbimit civile dhe ligji i punës, por ka qene edhe rregullorja e rekrutimit 02/10. Për konkursin që bëhet fjalë me dt. 02.02.2018, dy tri vite të fundit Komuna e Klinës, është ballafaquar në mungesë të stafi, nga se në QKMF punësohet një mjek dhe ai shkon në specializim nga se po lëshojnë punën dhe gjithmonë po krijohen kërkesa të reja, për punësim të ri. Tutje ka deklaruar ne kemi pasur të shpallur konkursin për mjeke të praksës së përgjithshëm, dhe shpesh herë është dashur me marrë mjekët nga Komuna tjera. Kanë qenë pesë aplikant, por nuk i kujtohet a kanë qenë të gjithë aplikantët nga Klina apo edhe te Komunave të tjera. Listën e aplikanteve ua ka dorëzuar panelit intervistues dhe paneli intervistues e ka zhvilluar procedurën, ngase janë kompetent me vazhduar procedurën. Kryetarit nuk i dërgohen lista e aplikanteve dhe as aplikacioni, kjo është procedure ligjore, Kryetari vetëm e formon komisionin, ky e shkruan

vendimin për formimin e komisionit dhe kryetari e nënshkruan, dhe pastaj komplet dosja i dorëzohet komisionit përzgjedhës - rekrutues. Procedura e rekrutimit për mjekët është e njëjte si të shërbyesit civil, mirëpo kur është fjala për mjeket do me thënë zbatohet ligji i punës. Në pyetjen se a ka rregullore QKMF-ja ? Dëshmitari ka deklaruar se QKMF-ja e ka vetëm statutin e QKMF-se, statuti ekziston por ne cilin vit është bërë nuk e di. Me tutje thekson se siç e ka cekur në fillim i kanë plane të personelit dhe ato i dërgojnë në MAP ne Prishtinë, dhe ajo aprovohet edhe nga ata, këta i parashohin pozitat se kush del në pension, dhe atë planë ia dërgojnë edhe QKMF dhe Drejtorisë. Kërkesën mund ta bënë edhe Drejtori i drejtorisë edhe drejtori QKMF-se, se edhe drejtori i QKMF-se i ka ato kompetenca kur është pozita e lire sipas planit. Kërkesa për inicimin e procedurës vjen në zyrën e tij dhe shkon në zyrën e kryetarit, dhe shihet se a është sipas planit dhe miratohet nga kryetari, dhe kjo është procedure e caktuar që nuk mund ti ikin.

Pas përfundimit të konkursit, kryetari ka pasur për vete vetëm vendimin për me themeluar panelin. Listën e aplikatëve e ka pasur paneli. Ju ka dërguar kryetarit vendimit për me themelimin e panelit, dhe kryetari e shikon dhe e nënshkruan, këta i propozojnë. Kur themelohet paneli intervistues, rregullorja e përcakton se kush duhet të jetë pjesë e panelit. Na i propozojmë, QKMF i propozon dhe kryetari mundet me refuzuar, i njëjti deklaroi se ne merrëm vesh me gojë e me shkrim. Ky e njofton kryetarin se është mbyllur konkursi dhe nuk e njoftoi se kush ka aplikuar, por vetëm e njoftoi se është mbyllur. Ky e ka pa listën e aplikantëve ka ditur që ka aplikuar M.E., por se ka ditur që është vajza e kryetarit.

Pasi që paneli e kishin njoftuar kryetarin se njëra nga aplikantët është vajza e tij, ai e kishte njoftuar këtë verbalisht dhe nuk e di se a ka qenë dikush prezent kur e ka njoftuar. E di që pastaj ia ka bartur kompetencat nënkryetarit. Nuk e di se kush e ka njoftuar por e di se i ka deleguar kompetencat. E di se akt emërimit e ka nënshkruar nënkryetari. Për paraqitjen e konfliktit të interesit nga ndonjë zyrtarët duhet te njoftoni me shkrim zyrën e personelit e pastaj zyra e personelit kryetarit. Panelistat kanë obligim me njoftuar këtë si zyrtar personeli e ky duhet ta njoftoj kryetarin ata kanë konflikt interesi. Në këtë rast ata nuk e kanë njoftuar këtë.

Më pas duke u përgjigjur në pyetje të mbrojtjes dëshmitari ka deklaruar se e "potencova edhe me herët që ne fund të vendimit janë 3 dite ankesë që ata kanë të drejtë me deklaruar konfliktin e interesit, por në rastin konkrete ata nuk e kanë deklaruar as për vete e as për kryetarin". Ky nuk e di se pret kujt ka kuptuar kryetari-këtu i akuzuari se ka konflikt interesi pasi që ia ka bartur kompetencat nënkryetarit. Me Agjensionin kundër korrupsionit nuk kanë ndonjë pikë të kontaktit por kur kanë ndonjë telashe i thërrasin në personel.

Dëshmitari XH.RR. në dëshminë të dhënë para gjykatës me dt.09.11.2020 e tij ka deklaruar se ka qenë anëtar i komisionit të themeluar me datë 20.02.2018, arsye pse ka qenë anëtar i komisionit ka qenë i vetmi jurist në QKMF në Klinë. QKMF është institucion i kujdesit shëndetësor dhe në bazë të ligjit për vetëqeverisjen lokale dhe ligjit për shëndetësi në kujdesin primar shëndetësor udhëheq Komuna. QKMF fillimisht e bënë kërkesën për inicimin e procedurës së regrutimit tek organi i punësimit. Kërkesa dorëzohet në zyrën e personelit në Komunë dhe pas miratimit të saj konkursin e shpall zyra e personelit. Zyra e personelit e ka pranuar dokumentin e aplikantëve dhe pas skadimit të afatit të konkursit në afatin e rregullt ligjor i është dorëzuar komisionit për intervistim ky ka qenë në komision. Për intervistë janë thirr kandidatët e paraqitur në konkurs me shkrim dhe ata të cilët kanë marrë numrin mbi 50 të poenëve janë thirr në intervistë me gojë. Nga komisioni është bërë vlerësimi i penave të gjithë kandidatëve në dy intervista komisioni në bazë të poenëve e ka vlerësuar se cili kandidat i plotëson kushtet e konkursit për pranim. Në këtë rast komisioni ka vlerësuar se numër më të madh të poenëve ka marrë M.E.. Ankesë pas zgjedhjes së kandidatit nuk e din a ka pas, s'ka qenë i njoftuar, ngase ankesat bëhen në Komunë në zyrën e personelit. I njëjti ka deklaruar se nuk e ka ditë kush ka konkurruar dhe vetëm pasi i ka marrë dosjet e ka ditë, janë zgjedh si komision vetëm pas shpalljes së konkursit, bile në atë konkurs ka aplikuar edhe një kushëri i këtu dëshmitarit dhe ky nuk e ka ditë. Kryetari i Komunës Z.E. nuk e ka njoftuar se në këtë konkurs është paraqit konflikt i interesit. I njëjti ka qenë kryetar i komisionit dhe se në çdo konkurs për punësim ka zgjidhje të veçantë dhe komisioni nuk është të njëjtë. dhe se ka marrë pjesë shpesh herë në konkurse për punësim në QKMF. Sa i parket konfliktit të interesit konsideron se zyra e personelit në Komunë është dashtë që kryetarit të ia tërheq vërejtjen për shkak se juristët janë për mos me lënë me bo gabime.

Dëshmitari G.B.j në dëshminë e tij të dhënë para gjykatës me dt.09.11.2020 ka deklaruar se ka qenë anëtar i komisionit të themeluar me datë 20.02.2018, Komisioni mundet me ditë kush ka aplikuar vetëm pasi i pranon dosjet dhe i përgatitë listën e ngushtë për ti ftuar kandidatët për intervistë, kanë vendos sipas meritokracis dhe kandidati ka qenë më i miri. Para se me dal lista e ngushtë i kanë shikuar dosjet a kanë licencë dhe a i plotësojnë kriteret dhe atëherë vendosin dhe e bëjnë listën e ngushtë dhe i ftojnë kandidatët për intervistë. Komisioni për zhvillimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës nuk e din kur formohet sepse është punë administrative. I njëjti si anëtar i komisionit është caktuar me vendim dhe është mjek në QKMF dhe procedurat administrative nuk i njeh. Raporti final i rekomandimit prej komisionit rekrutues

del pas tri ditësh, mandej ftohen kandidatët që kanë kaluar 50% dhe mbahet intervista me gojë dhe mandej del rezultati. Raportin final e aprovojnë të gjithë anëtarët e komisionit dhe kryetari i komisionit. Dëshmitari deklaron se raporti final i rekomandimit prej komisionit rekrutues i datës 28.02.2018 është çështje administrative dhe nuk është pjesë e komisionit që e nënshkruajnë sepse ata e nënshkruajnë vetëm raportin final vlerësimin e kandidatit. Ka qenë pesë gjashtë herë të tjera në konkurse të tjera kryetar i komisionit. Askush nga personeli apo ndokush nga Komuna nuk e ka njoftuar që Kryetari Z.E. ka paraqitur konflikt interesi në këtë çështje. Dëshmitari deklaron se M.E. e ka shkëputë marrëdhënien e punës në QKMF ka një vit dhe ka shkuar si mjeke në Gjermani, QKMF ka pas mungesë të mjekëve dhe janë detyruar që të marrin prej Istogut si dhe prej komunave të tjera të Deçanit si pasojë e mungesës së mjekëve.

Dëshmitari B.H. në dëshminë e tij të dhënë para gjykatës me dt.09.11.2020 ka deklaruar se ka qenë anëtar i komisionit të themeluar me datë 20.02.2018, në këtë rast kanë vendos sipas meritokracisë. Pasi që kanë hyrë në panel e kanë parë listën kush janë kandidatët që kanë apliku për doktor, i kanë ftuar me emër kush ka qenë prezent dhe kanë hy brenda janë shpërnda testet me shkrim dhe nuk ka pasur ndonjë pa rregullsi sa i përket asaj, ka fillua testi nuk e dinë saktë sa ka zgjatë, ka përfunduar dhe i kanë mbledh testet paneli i ka vlerësuar dhe shumica kanë qenë mbi 50 %. Vlerësimi nga këtu dëshmitari ka qenë transparent, maksimumi i pikëve ka qenë 10 pikë ka pas 6,8 dhe 10 që i kanë vlerësuar. Nga komisionit i kishte ardhur njoftimi dhe drejtori i Inspektoratit i ka treguar se është anëtar i komisionit, asnjërin nga aplikantët nuk i ka njohur, mirëpo shumë vonë e ka kuptuar se M.E. është vajza e Kryetarit, vetëm pasi që e kanë akuzuar Kryetarin e ka kuptuar. Nuk ka qenë i njoftuar se kryetari i komunës ka paraqitur konflikt interesi dhe se Marigona është vajza e të kryetarit. Dëshmitari po ashtu deklaroi se nga ana teknike i ka vlerësuar kandidatët ndërsa në komision i kanë pas dy mjekë që i kanë vlerësuar pyetjet profesionale.

Ndërsa provat materiale që ishin administruar në këtë shqyrtim gjyqësor, kërkesa për inicimin procedurës së rekrutimit – punësimit me nr. 31 të datës.02.01.2018 nga QKMF Nënë Tereza në Kline, Konkursi publik me nr.02 nr.1115712018 të datës 02.02.2018, vendimi për formimin e komisionit rekrutues i datës 28.02.2018 i datës 20.02.2018, raporti final i rekomandimit i datës 28.02.2018, shpallja e rezultateve të procedurës së rekrutimit me nr. 112-1249/2018 i datës 01.03.2018, njoftimi i raportit final me rekomandimin e datës.28.02.2018, kontrata e punës për kohe të pacaktuar me nr. 112-2191/2018 të datës 26.03.2018, deklarata e të pandehurit e dhënë

në prokurori me datë 02.09.2019, deklarata e dëshmitarit B.H. e dhënë në prokurori me datë 18.10.2019 si dhe mbrojtjen e të akuzuarit.

Nga kërkesa për inicimin e procedurës së rekrutimit rezulton se QKMF Nënë Tereza i ishte drejtuar Komunës së Klinës për kërkesën e pranimit të një mjeku të praksës së përgjithshme.

Nga konkursi publik rezulton se Komuna e Klinës kishte hapur konkursin publik sipas kërkesës së parashtruar nga QKMF – ja për pranimin e një mjeku të praksës së përgjithshme.

Nga vendimi i datës 20.02.2018 rezulton se i akuzuari kishte themeluar komisionin për rekrutimin sipas konkursit publik – Mjek i praksës së përgjithshme në QKMF Nënë Tereza në Klinë.

Nga raporti final i komisionit rekrutues i datës 28.02.2018 rezulton se ishte përmbyllur procesi i komisionit për rekrutim.

Nga shpallja e rezultateve me datë 01.03.2018, rezulton se pasi ishte zhvilluar procedura e rekrutimit ishte bërë shpallja e rezultateve të procedurës së rekrutimit.

Nga kontrata e punës rezulton se ishte lidhur kontrata e punës ndërmjet komunës së Klinës dhe M.E. si mjeke e prakesës së përgjithshme, qe ishte nënshkruar nga nënkryetari i Komunës.

Kolegji i Gjykatës së Apelit duke rrethanat e fakteve në këtë çështje penale detyrimisht duhet të vlerësoj se a konsumohen elementet e veprës penale për të cilën akuzohet i akuzuari.

Më konkretisht kjo vepër penale në nenin 424 paragrafi 1 përcakton se: *“Personi zyrtar i cili merr pjesë personalisht në ndonjë çështje zyrtare në të cilën ai apo ndonjë anëtar i familjes ose ndonjë person juridik që ka të bëjë me të ka interes financiar, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet”.*

Ndërsa paragrafi 3 përcakton se: *“Për qëllime të këtij neni, shprehja “merr pjesë” nënkupton ushtrimin e autoritetit zyrtar përmes vendimit, miratimit, mosmiratimit, rekomandimit, këshillimit, hetimit ose në ndonjë mënyrë tjetër të ushtrimit të ndikimit për një çështje zyrtare”.*

Ne rastin konkret Gjykata e Apelit duhet të ketë parasysh se faktet për të cilat ngarkohet i akuzuari, a i konsumojnë këto elemente të veprës penale, nga paragrafi 1 i nenit 424.

Nga provat qe gjinden në shkresat e lëndës, rezulton se nuk janë kontestuese këto fakte:

1. Se i akuzuari ishte person zyrtar – kjo për faktin se ishte në cilësinë e kryetarit të Komunës, dhe ishte i zgjedhur.

2. Poashtu nuk ishte kontestuese se në procedurën e konkurrimit ishte përfshirë një anëtar i familjes së të akuzuarit, konkretisht kishte lidhur marrëdhënie të punës ku ishte punësuar vajza e të akuzuarit në një procedurë të konkursit publik që ishte shpallur nga Komuna e Klinës për QKM- Klinë në pozitën Mjek i praksës së Përgjithshme.
3. Procedura e marrëdhënies së punës ku ishte punësuar M.E. që ishte vajza e të akuzuarit, kishte të bënte me interesin financiar pasi që vetvetiu marrëdhëniet e punës lidhet edhe për qëllim të kompensimit dhe këtu krijohet interesi financiar.

Fakti me thelbësor në këtë çështje penale për Gjykatën e Apelit rezulton se, kur i akuzuari kishte marrë pjesë në këtë procedurë të konkursit publik cili ishte veprimi i tij, dhe si nga aktakuza por edhe nga provat që gjinden në shkresat e lëndës rezulton se, i akuzuari ngarkohej se: “kishte marrë vendimin për themelimin e komisionit për rekrutim”.

Ne këtë këndvështrim Gjykata e Apelit vlerëson se ky veprim i të akuzuarit a bie në domenin e dispozitës së nenit 424 paragrafi 3 që përcakton se çka nënkupton “merre pjesë”, dhe Poashtu me veprimin e të akuzuarit a krijohet interesi financiar apo ka një mori veprimesh të tjera që rezulton në krijimin e interesit financiar.

Kolegji ka parasysh se procedura e konkursit publik duhet të përcillet me disa hapa që janë: 1. Kërkesa e organit që kërkon plotësimin e vendimeve të punës – në rastin konkret QKMF, 2. Marrja e vendimit për hapjen dhe shpalljen e konkursit publik që në rastin konkret e merr sektori i personelit, 3. Vendimi për themelimin e komisionit rekrutues që e merrë nivelin më të lartë i zyrtarit administrativ – në rastin konkret kryetari i komunës, 4. Shqyrtimi i dokumentacionit nga komisioni rekrutues, 5. Njoftimi i kandidatëve në procedurë dhe nënshtrimi i testeve dhe intervistë që e ndërmerret komisioni rekrutues, 6. Njoftim i kandidatëve që rangohen me pikë, 7. Njoftimi përfundimtar për kandidatin e suksesshëm, 8. Rekomandimi i përzgjedhjes së kandidatit, 9. Lidhja e kontratës.

Në këtë kontekst Gjykata e Apelit vëren se i akuzuari siç edhe ngarkohej me akuzën e prokurorisë vetëm kishte marrë vendimin për themelimin e komisionit në përputhje me dispozitat ligjore që ai detyrohej që të themelonte komisionin rekrutues, por nga ky veprim ai nuk kishte ndërmarr asnjë veprim të mëtejshëm në këtë çështje administrative, andaj në këtë kontekst duhet pasur parasysh se marrja e vendimit të tillë a kishte krijuar interes financiar për personin familjar të të

akuzuarit, si dhe kjo marrje pjesë në këtë vendim a ishte në domenin e dispozitës së nenit 424 paragrafi 3.

Fillimisht nga deklarata e dëshmitarëve – anëtarëve të komisionit rekrutues që ishin dëgjuar në cilësinë e dëshmitarëve, asnjëri nga këta nuk kishte lënë mëdyshje se i akuzuari në çfarëdo forme duke e marr këtë vendim të ketë pasur çfarëdo efekti të ushtrimit të pushtetit në përzgjedhjen e kandidateve. Madje nga deklarata e dëshmitarëve rezulton se ata as nuk kishin pasur dijeni se M.E. kishte qene vajza e të akuzuarit. Kjo rrethanë për Gjykatën e Apelit është fakte thelbësor, nga se fakti i marrjes së vendimit a ishte i përfshirë me ushtrimin e pushtetit në kuptim të përcaktimit të interesit financiar që kishte anëtari i familjes së të akuzuarit apo thjesht ai themeloi komisionin nga se detyrohej nga dispozitat ligjore që ai ka kompetencë për themelimin e komisionit. Duke pasur parasysh deklarata e dëshmitarëve – anëtarëve të komisionit rekrutues që kanë theksuar se asnjë diskutim nuk kane pasur me të akuzuarin lidhur me procedurën e rekrutimit dhe marrë për bazë se në kuadër të komisionit rekrutues nuk ishin vetëm persona zyrtar të administratës në nivelin Komunal por ishin edhe mjek që nuk janë vartës në hierarkinë e Komunës, kolegji vlerëson se në vetvete marrja e një vendimi për themelimin e komisionit rekrutues vetëm si aspekt formal nuk e provon faktin se kjo marrje pjesë në procedurë ishte bërë për qellim të ushtrimit të pushtetit siç dispozita nga paragrafi 3 përcakton që pushteti të ushtrohej me qellim ndikimi në këtë çështje zyrtare.

Përveç faktit se siç u theksua nuk provohet se marrja pjesë e të akuzuarit ishte bërë për qellim të ushtrimit të pushtetit në kontekst të ndikimit, njëkohësisht nga vet procedura ligjore që rregullohet me rastin e një konkursi publik nuk rezulton se një veprim i tillë krijon interes financiar, nga se si tërsi kjo procedure interesin financiar e krijon në momentin kur ka lidhje të kontratës, gjë që nga provat rezulton se i akuzuari që në momentin kur kishte kuptuar se ishte rekomanduar vajza e tij, ai nuk kishte ndërmarr asnjë veprim të mëtejshëm në këtë procedurë të rekrutimit, por veprimet e mëtejshme i kishte ndërmarr zëvendës kryetari dhe i akuzuari thjesht kishte abstenuar në ushtrimin e çfarëdo pushteti të mëtejshëm në këtë procedurë, edhe pse në fazën e tillë çdo kandidat kishte të drejt që të parashtronte ankesa në tersin e procesit, përkundër se vet i akuzuari nuk kishte ndërmarr asnjë veprim pas që komisioni rekrutues kishte rekomanduar vajzën e të akuzuarit. Këto rrethanat vërtetojnë faktin se me veprimin e të akuzuarit nuk ishte krijuar interes financiar për anëtarin e familjes, pasi që fakti i ndërmarrjes së një veprimi në një moment zyrtar dhe tërheqja nga veprimet e mëtejshme kur ati zyrtarisht i ishte vënë në dijeni se ishte rekomanduar vajza e ti si kandidate më e mirë, të gjitha këto provojnë faktin se me vet



veprimin e themelimit të komisionit rekrutues nuk ishte krijuar interesi financiar sepse dispozita ligjore në nenin 424 paragrafi 1 përcakton “ka interes financiar” çka rezulton se interesi financiar duhet të rezultojë si pasojë e veprimit dhe jo thjesht të konsiderohet se ka rezultuar.

Gjykata e Apelit ka parasysh se kontrata e nënshkruar në procedurën e konkursit publik për marrëdhënien e punës, ishte nënshkruar, nga kandidatja M.E. dhe Komuna e Klinës, ku e kishte nënshkruar nënkryetari i komunës, “Për dhe nënshkrimi i nënkryetarit”, rrjedhimisht sipas dispozitave ligjore të ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, në nenin 60 paragrafi 3 përcaktohet se, në mungesë të Kryetarit të Komunës të gjitha detyrat kryhen nga nënkryetari i Komunës, gjë që në rastin konkret nga deklaratat e dëshmitarit B.H. rezulton se kontratën e kishte nënshkruar nënkryetari pasi që kryetari nuk kishte qenë në punë por në detyra jashtë vendit, prandaj fakti i tillë se kryetari kishte qenë jashtë vendit në mungesë të ndonjë prove nuk e bënë të paqenë këtë fakt se në të vërtetë i akuzuari si kryetar i Komunës kishte qenë jashtë vendit, nga se për një fakt që pretendohet se ka ndodhur detyrohet prokuroria që të vërtetojë të kundërtën e asaj që pretendon i akuzuari, por këtë fakt që ka theksuar se kishte qenë jashtë vendit prokuroria nuk ka ofruar asnjë provë për ta vu në mëdyshje këtë fakt se i akuzuari kishte qenë jashtë vendit kur ishte nënshkruar kontrata, madje sipas udhëzimit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal nr. 2014/01 të datës 31.01.2014, neni 3 Përgjegjësit e nënkryetarit të Komunës, paragrafi 2 përcakton se: Në të gjitha rastet e mungesës së Kryetarit, “nënkryetari i komunës është i obliguar të zëvendësojë dhe të veprojë në emër të kryetarit”, dhe kur veprohet në emër të kryetarit të komunës kjo nuk duhet kuptuar se përgjegjësia për ato veprime i mbetet kryetarit, pasi që këtu kemi delegim të kompetencave sipas vet dispozitave ligjore nga kryetari të nënkryetarit kur ka mungesë të kryetarit.

Poashtu Gjykata ka parasysh faktin se, i akuzuari nuk kishte ndërmarr ndonjë veprim formal për të shmangur konfliktin e interesit, megjithatë dispozitat e ligjit për vetëqeverisje lokale në nenin 59 paragrafi 4 i Ligjit nr. 03/L-040, përcaktojnë se kur kryetari i komunës gjendet në situatë që mundë të jetë konflikt i interesit, ai mund të njoftoj Agjencinë kundër korrupsionit për shmangien e konfliktit të interesit apo edhe mund të shmang konfliktin e interesit vet, gjë që në situatën konkrete kolegji i Gjykatës së Apelit duke vlerësuar se veprimi mbi themelimin e komisionit rekrutues vetëm si veprim formal procedural kjo në vetvete nuk mund të përbëjë konflikt të interesit, nga se në atë fazë ende nuk kishte ndërmarrje të veprimeve për të njohur çfarëdo të drejtë kandidatëve që ishin pjesëmarrës në atë procedurë dhe vetëm ky veprim pa u vërtetuar ndonjë rrethanë se përmes këtij veprimi ka përdorur pushtetin i akuzuari, nuk është veprim i

natyrës se tillë që krijon interes financiar për anëtarin e familjes apo për vet të akuzuarin, nga se interesi financiar me atë veprim nuk rezultonte, nga ana tjetër nuk provohet se i akuzuari me këtë veprim të këtë përdorur pushtetin e tij por thjesht ka nxjerr një akt formal vetëm ku ka themeluar komisionin për rekrutim, ndërsa fakti se ai nuk e ka nënshkruar kontratën por kontrata është nënshkruar nga nënkryetari i komunës kjo në vetvete përbënë shmangie të konfliktit të interesit sipas nenit 59 paragrafi 4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale akt ky mbi të cilin ushtrohen kompetencat nga kryetari i Komunës.

Gjykata e Apelit në këtë çështje penale ka parasysh faktin më thelbësor që rezulton, se i akuzuari a ka qenë në dijeni për faktin e aplikimit të vajzës së tij në këtë konkurs, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se nga faktet e çështjes nuk rezulton se i akuzuari të këtë qenë në dijeni për aplikimin e vajzës së tij në këtë konkurs nga se siç ka deklaruar dëshmitari XH.D. se Kryetarit të Komunës si zyrtar kryesor Administrativ nuk i dorëzohet lista e kandidateve por vetëm e themelon panelin me vendim, por përtej këtij fakti se a ka qenë në dijeni i akuzuari se si aplikant ishte edhe vajza e tij që nga provat rezulton se lista nuk i dërgohet atij, kolegji vlerëson se vendimi për themelimin e komisionit rekrutues nuk mund të përbëjë në vetvete veprim të ndërmarr në konflikt të interesit, kur i akuzuari nuk kishte ndërmarr asnjë veprim paraprak e ndërsa themelimi i komisionit për rekrutim me vendimin e të akuzuarit ishte marr me datë 20.02.2018, ndërsa konkursi ishte shpallur me datë 02.02.2018, madje edhe rekomandimi i komisionit rekrutues me kandidatët që kanë kaluar testimet, ishte aprovuar nga nënkryetari i komunës me datë 28.02.2018, në të cilin raport rezulton se ishte e M.E., çka tregon se si veprim ku anëtari i familjes i rezulton një interes në këtë procedurë është pikërisht momenti i rekomandimit nga komisioni, por që i akuzuari nuk kishte ndërmarr asnjë veprim pasi që ishte vë në dijeni se behej fjale për vajzën e tij, ndërsa para themelimit të komisionit nuk rezulton se ishte ndonjë interes i anëtarit të familjes si pasoj e ndërmarrjes së veprimit të të akuzuarit, pasi që komisioni rekrutues ishte themeluar nga i akuzuari por që ky komision ishte përcaktuar për konkursin e shpallur e jo komision në raport me anëtarin e familjes por në raport me të gjithë kandidatët, rrjedhimisht pasi që ishte shfaqur vajza e tij ai nuk ka ndërmarr asnjë veprim në këtë çështje administrative, andaj çështja e konfliktit të interesit duhet vlerësuar nga momenti i shfaqjes së asaj gjendje që e shkakton konfliktin e interesit gjë që kur ishte themeluar komisioni për rekrutim gjendja e konfliktit të interesit nuk rezulton të jetë e shfaqur pasi që veprimi ndërlidhej me konkursin që ishte i shpallur dhe jo me subjektin që ka interes në këtë procedurë.

Gjykata e Apelit ka parasysh provat që janë administruar në këtë çështje penale dhe ato i ka vlerësuar, me konkretisht ua ka falur besimin deklaratave të dëshmitarëve. Me konkretisht ua ka falur besimin deklaratës së dëshmitarit, B.H. i cili kishte sqaruar rrethanat e këtij rasti penal ku ai ka pohuar se, me kryetarin kam folur për fëmijët e tij dhe fëmijët e mi kur kemi bere biseda të lira, i kujtohet që ka nënshkruar në emër të kryetarit shumë vendime por nuk e din për cilin rast, por kur behet fjale për nënshkrimin për vajzën e kryetarit ai këtë nënshkrim e ka bërë në mungesë të kryetarit. Pra nga vet deklarata e këtij dëshmitari provohen faktet se ky dëshmitar ishte në cilësinë e nënkryetarit ku kishte edhe autorizim dhe se ai kishte nënshkruar në kohen kur kryetari nuk ishte prezent, prandaj deklarimi i këtij dëshmitari është i besueshëm për këto rrethanë të fakteve nga se siç rezulton kjo deklaratë është në përputhje me faktet dhe provat që gjinden me shkresat e lëndës dhe se ai kishte nënshkruar kontratën mbi bazën e dispozitave ligjore të ligjit për vetëqeverisjen lokale.

Sa i përket faktit se ai ka deklaruar se ka biseduar me kryetarin lidhur me vajzën e tij se i ka thënë se di qysh mundem me marr një vajze se ajo është e mire, kjo rrethanë nuk konsiston në provueshmërinë përtej çdo dyshimi lidhur me veprimet e të akuzuarit, pasi që fillimisht dëshmitari nuk pohon se kanë biseduar për këtë rast konkret, se ai nuk përcakton kohë kur ka ndodhur kjo bisedë si dhe nuk rezulton se kur kanë biseduar kanë biseduar konkretisht për këtë raste ku kishte aplikuar vajza e të akuzuarit, prandaj në mungesë të provave përtej çdo dyshimi lidhur me faktin se i akuzuari a ka qenë në dijeni duke pasur mangësi deklarata e dëshmitarit për rrethanat specifike se në të vërtet, a ka biseduar i akuzuari me dëshmitarin për rastin konkret për konkursin konkret dhe për vajzën e të akuzuarit, kolegji vlerëson se lidhur me këtë rrethanë deklarata e dëshmitarit për këtë pjese mbetet si e vetme e në mungesë të rrethanave të sqarimit specifik të çështjes, për këtë kolegji kjo pjese e deklaratës nuk vërteton përtej çdo dyshimi faktin se i pandehuri ka qenë në dijeni se vajza e tij ka aplikuar, kur ai ka ndërmarr vendimin për themelimin e komisionit rekrutues.

Gjykata e Apelit poashtu ia ka falur besimin e plotë deklaratës së dëshmitarit, XH.D. nga e cila deklarate rezulton se provohen këto rrethana të fakteve, se ky dëshmitar në cilësinë e shefit të shërbimit të personelit mbështetur në kërkesën e iniciuesit për punësim nga QKMF-ja kishte marr vendimin për shpalljen e konkursit për një mjek specialist të praksës së përgjithshme. Pasi që është përmbyllur konkursi është formuar paneli intervistues – komisioni për rekrutim dhe ky vendim merret nga zyrtari kryesor administrativ – kryetari. Panelit intervistues i dorëzohet lista dhe dosja complete e aplikanteve. Paneli i merr listat dhe formon listën e ngushtë me aplikant,

pastaj caktohet data e testimi me shkrim, pas këtij testimi caktohet dita e intervistimit gojor, mblidhen piket ndërmjet dy intervistimeve dhe del kandidati më i suksesshëm. Nga deklarata e këtij dëshmitari Poashtu vërtetohen faktet se vendimi për panelin intervistues përpilohet nga udhëheqësi i burimeve njerëzore të cilin vendim po ky dëshmitar e ka përpiluar, ndërsa vendimin vetëm e nënshkruan Kryetari. Poashtu nga deklarata e këtij dëshmitari vërtetohet fakti se përveç draft vendimit të përpiluar nga udhëheqësi i burimeve njerëzore të Kryetari – si zyrtar kryesor administrativ nuk dorëzohet as lista e aplikantëve dhe as dosjet e aplikantëve, lista dhe dosjet dorëzohen vetëm të komisioni përzgjedhës.

Deklarata e dëshmitarit për këtë kolegji përveç se vërteton këto rrethana se ai kishte miratuar kërkesën për inicim nga QKMF-ja dhe se ai kishte bërë shpalljen e konkursit si dhe ai kishte përpiluar vendimin me emrat e komisionit përzgjedhës që sipas dispozitave ligjore i akuzuari në cilësinë e kryetarit vetëm e kishte nënshkruar e për këtë vendim nuk i janë dorëzuar lista dhe dosjet e kandidateve, provon përtej çdo rrethane se i akuzuari veprimin e kishte ndërmarr brenda kompetencave të tij dhe vendimi i ndërmarr në këtë procedurë nuk i atribuohet veprimit në raport me anëtarin e familjes por thjeshtë përderisa ishte konkursi publik ku kishte kandidat që kishin aplikuar, kjo nuk e inkorporon veprimin në një procedurë nga i akuzuari që i dedikohet si vendim konfliktit të interesit pasi që te konflikti i interesit çështja duhet shqyrtuar rast pas rasti dhe rrjedhimisht përderisa i akuzuari nuk ishte i pajisur edhe me listën e kandidateve, ai vendimin e kishte marr për tu zhvilluar procesi intervistues çka nënkupton se ky veprim nuk e determinonte shfaqjen e interesit financiar në këtë fazë pasi që ishte që në fillimet e para zhvillimi i procedurës rekrutuese.

Deklarata e dëshmitarit Xhemaj Rraci për kolegjin e Gjykatës se Apelit është e besueshme në raport me rrethanat e fakteve, nga kjo deklaratë vërtetohet se QKMF kishte iniciuar kërkesën për pozitën Mjek në këtë institucion drejtuar zyrës së personelit në Komunën e Klinës, se kandidatet dokumentet i dorëzojnë në zyrën e personelit dhe ato aplikime janë dorëzuar nga zyra e personelit në Komision, komisioni ka bërë intervistimin dhe testimin e të gjithë kandidatëve që kanë plotësuar kushtet dhe është poentuar me numrin më të madh M.E.. Nga deklarata e këtij dëshmitari nuk rezulton se i akuzuari Z. E. të ketë pasur çfarëdo komunikimi për të ushtruar pushtet në këtë çështje administrative në raport me komisionin rekrutues, madje vet dëshmitari pohon se vetëm pasi që jam përzgjedhur anëtar i komisionit kam vërejtur se kandidatë ka qenë edhe M.E.. Nga deklarata e këtij dëshmitari poashtu nuk rezulton i provuar ndonjë rrethanë se i akuzuari të ketë ndërmarr çfarëdo veprimi në këtë çështje administrative në interes të ndonjë

kandidati, por se ai ishte caktuar si Kryetar i Komisionit nga se ishte i vetmi Jurist në QKMF të Klinës.

Deklarata e dëshmitarit B.H. për kolegjin e Gjykatës së Apelit ishte e besueshme nga se, kjo deklaratë ishte në mbështetje të fakteve dhe e përputhshme edhe me provat tjera në këtë çështje penale dhe nuk kishte kundërshtime kjo deklaratë në raport me provat tjera në këtë çështje penale, për faktet vendimtare, mbi bazën e kësaj deklarate Poashtu vërtetohet se, komisioni kishin pranuar aplikimet e kandidateve nga zyra e personelit, dhe se i kishin ftuar të gjithë kandidatët që kishin plotësuar kushte, ai nuk kishte qenë në dijeni se vajza e të akuzuarit kishte qenë njëra nga kandidatet në këtë konkurs publik, nga dëshmitari vërtetohet fakti se për faktin se vajza e të akuzuarit kishte qenë në dijeni se ishte kandidate vetëm kur ishte ngritur akuzë ndaj të akuzuarit. Nga kjo deklaratë poashtu kolegji vërteton se, i akuzuari nuk kishte vënë asnjë komunikim me ndonjërin nga anëtarët e komisionit për të ardhur në konkludim se ai kishte dijeni për aplikimin e vajzës se tij në konkursin publik, por nga ana tjetër fakti se dëshmitari në asnjë moment nuk kishte pohuar se ishte në dijeni se vajza e të akuzuarit ishte kandidate kjo vërteton faktin se i akuzuari nuk kishte ndërmarr asnjë veprim për ndonjë interes në raport me anëtarin e familjes së tij – vajzën e tij që ishte vetëm njëra nga aplikuesit në konkursin publik.

Kolegji i Gjykatës së Apelit ua ka falur besimin provave materiale që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor, nga të cilat vërtetohen faktet se, kishte kërkesë nga QKMF për incjimin e procedurave për një mjek në këtë qendër mjekësore, Poashtu se kërkesa ishte miratuar nga zyra e personelit dhe ishte shpallur konkursi publik, dhe se vendimi për themelimin e komisionit rekrutues në këtë konkurs e kishte nënshkruar i akuzuari si Zyrtar Kryesor Administrativ. Se komisioni kishte ftuar të gjithë kandidatët dhe se kishte përpiluar rekomandimin që i ishte drejtuar të akuzuarit, mirëpo që këtë rekomandim nuk e kishte nënshkruar dhe miratuar i akuzuari por nënkryetari i Komunës dhe se përfundimisht ishte dhënë rekomandimi për lidhjen e kontratës me kandidatin më të suksesshëm M.E. e ku nënkryetari i Komunës e kishte nënshkruar kontratën në emër të Komunës që kishte ushtruar kompetencat sipas ligjit për vetëqeverisje lokale.

Marre për bazë të gjitha këto rrethana që vërtetohen nga këto prova materiale, kolegji ka parasysh se përderisa i akuzuari kishte ndërmarr vetëm veprimin për themelimin e komisionit por që ky komision ishte me detyra që të veprojnë në raport me konkursin pavarësisht kush ishin kandidatet, dhe marrë për bazë faktin se i akuzuari që në momentin kur komisioni kishte rekomanduar si kandidatën më të suksesshme – vajzën e tij, këtu rrjedhe momenti i shfaqjes së gjendjes së

konfliktit të interesit nga se tashmë ajo ishte e përcaktuar si kandidate më e mira dhe çdo veprim i të akuzuarin më tej në këtë procedurë do të konsumonte elementet e veprës penale të konfliktit të interesit sepse bëhej falë për emrin e përveçëm të anëtarit të familjes që ishte rekomanduar tashmë si kandidat i suksesshëm, ndërsa para se të bëhej çfarëdo përzgjedhje nga ana e komisionit detyrimet e tyre konsistojnë në raport me të gjithë kandidatet, por çështja shtrohet këtu se a përbënte interes financiar pjesëmarrja e të akuzuarit në fazën kur kishte vetëm aplikim dhe jo njohje të çfarëdo të drejte të interesit financiar, gjë që në fazën kur i akuzuari kishte ndërmarr veprimin rezulton se ishte një komision që duhej të zhvillonte procedure në raport me kandidatët që kishin aplikuar dhe që në momentin kur ishte rekomanduar kandidatja si më e suksesshme M.E. i akuzuari nuk kishte ndërmarr më veprime në këtë drejtim, rrethanë kjo që edhe vet i akuzuari e kishte pohuar se ai kur ka parë këtë gjendje i ka njoftuar në bordin e drejtorëve se nuk do të ndërmerr veprime të mëtejshme për shkak se është shfaqur një gjendje e konfliktit të interesit dhe rrjedhimisht të gjitha veprimet tutje janë ndërmarr nga zëvendës Kryetari.

Gjykata e Apelit ka parasysh edhe opinionin e dhënë nga zyra e kryeprokurorit të shtetit që tërheq vërejtjen ndaj prokurorisë themelore se në situatën konkrete ndaj të akuzuarit duhet të rezultojë se veprimi i ndërmarr të jetë i përfshirë me ndonjë ushtrim të pushtetit në kuptim të ndikimit në të kundërtën nuk mund të rezultojë ekzistimi i veprimeve inkriminuese ndaj të akuzuarit, por siç rrjedhë nga aktgjykimi kjo provë nuk ishte vlerësuar, e pikërisht kjo përbënë provë në favor të të akuzuarit në mbështetje të nenit 7 të KPP-ës, pasi që rezulton se vet prokuroria kishte kërkuar një opinion për pasigurinë e trajtimit të këtij rasti se a kemi të bëjmë me veprim të konfliktit të interesit apo jo.

Gjykata e Apelit ka parasysh faktin se kontrata e marrëdhënies së punës ishte nënshkruar nga Nënkyetari i Komunës “ për” mirëpo lidhur me këtë fakt përveç se i akuzuari Z. nuk ngarkohej në akuze për këtë veprim, njëkohësisht rezulton se nënshkrimi nga nënkyetari i komunës ishte bërë në përputhje me dispozitat e ligjit për vetëqeverisje lokale.

Andaj për arsyet e theksuara si me lartë kjo Gjykatë bazuar në nenin 401 të KPRK-ës, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS  
PAKR.nr.70/2022 me datë 12.04.2022

B.profesionale  
Alba Makolli

---

Anëtarët e kolegjit  
Burim Ademi

---

Kryetare e kolegjit,  
Tonka Berishaj

---

Bashkim Hyseni

---